



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHITIME/OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHITIME



DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL
DIREKCIJA ZA POLJOPRIVREDU I RURALNI RAZVOJ
DIRECTORATE FOR AGRICULTURE AND RURAL DEVELOPMENT


Data/Datum/Date:	18.02.2025
Nr./Br./No	12/04
Për/Za/To:	Kuvendi i Komunës së Shtimes: z. Adnan Ademi
Përmes/Preko/Through:	Zyra e kryetarit të Komunës: z. Qemajl Aliu
Nga/Od/From:	Drejtore i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: Gojart Bajrami
Lënda/Predmet/Subject:	Propozim për anulimin e Vendimit Npi-01/346 datë 31.10.2024 për themelimin e vendgjuetisë në teritorin e komunës së Shtimes

Duke u bazuar në Vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Shtimes nga Departamenti ligjor i Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Komunën e Shtimes, i propozon Kuvendit që të anulohet Vendimi Npi-01/346 datë 31.10.2024 për themelimin e vendgjuetisë në teritorin e komunës së Shtimes.

Departamenti Ligjor në Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, konfirmon: “Vendimi Npi-01/346 për caktimin e vendgjuetisë së përbashkët në teritorin e komunës së Shtimes, të miratuar me datë 31.10.2024, parashtruar për shqzrtim në MAPK me datë 07.11.2024, pranuar në MBPZHR me datë 13.11.2024, është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë nuk mund të prodhojë efekte juridike.”

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i propozon Kuvendit për anulimin e këtij vendimi. DBZHR pas këtij hapi, do të kërkojë nga ana e Ministrisë në fjalë për hapat konkret se si duhet të veprohet në këtë situatë për të themeluar nga fillimi vendgjzetinë.

Faleminderit!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 27.01.2025

Arsim Zuka, Z.v, Avokat i Përgjithshëm Shtetëror

Lënda: Shkresë përcjellëse

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën IX të Rregullores së Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ka pranuar për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë, Vendimin Npi-01-346 për caktimin e vendgjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Shtimes.

MAPL, e ka pranuar aktin për vlerësim më datën 07.11.2024, dhe me datën 13.11.2024 me shkresë përcjellëse e ka përcjell në ministrinë e linjës MBPZHR. Pas vlersimit të Vendimit Npi-01/346 për caktimin e vendgjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Shtimes nga ministija përgjegjëse, është "kërkesën për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit.

Duke pasur për bazë afatin e përcaktuar për rishqyrtimin e aktit dhe shkresës përcjellëse të datës 03.12.2024, për Kryetarin e komunës së Shimes dhe Kryesuesin e Kuvendit të komunës së Shimes lidhur me vlersimin e vendimit Npi-01/346 nga MBPZHR, MAPL, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përkatësisht 82.4, ku sqarohet se: Nëse komuna nuk përgjigjet brenda afatit apo refuzon kërkesën, apo mbështet vendimin apo aktin e kontestuar, autoriteti mbikëqyrës mund ta kundërshtojë aktin në fjalë në Gjykatën që është kompetent për territorin e komunës, brenda 30 ditësh pas dështimit për t'iu përgjigjur njoftimit për refuzimin apo mbështetjen e vendimit apo aktit të kontestuar.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bazë të Rregullores Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, vlerëson se Ministria e Drejtësisë - Avokati i Përgjithshëm Shtetëror është kompetentë të dërgoj lëndën në gjykatë në pajtim me ligjin në zbatim të paraparë me neni 82.5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. Bazuar në këtë, bashkangjitur gjeni lëndën e kompletuar lidhur me këtë çështje.

Me respekt,

Jeton Qela


Sekretar i Përgjithshëm, MAPL

[Signature]
Kopje: Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së

Kryetari i Komunës së Shtimes,

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes,

Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Departament

Për:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës së Shtimes Adnan Ademi, Kryesues i Kuvendit K.K Shtime	
C.c:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm MAPL; Erblin Hetemi, U.d. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave; Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave; Sanije Dërguti, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave.	
Përmes:	Faton Peci, Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme në MBPZHR	
Nga:	Shefki, Zeqiri, Drejtor i Departamentit Ligjor,	Datë: 22.11.2024 Ref.10.2- 284/24
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtar konfirmues dhe hartues i vlerësimit ligjor	Shyhrete Bunjaku, Udhëheqëse e Divizionit për zbatim të legjislacionit	
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Shtimes	
Lloji i aktit:	Vendim Npi/46 për caktimin e vendgjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Shtimes, të miratuar me datë 31.10.2024, parashtuar për shqyrtim në MAPL me datën 07.11.2024, pranuar në MBPZHR me datë 13.11.2024	

I nderuar z. Kryetar,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 30.11.2022, ka pranuar nga MAPL aktin e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, pranuar në MBPZHR me datë 13.11.2024, me qëllim të shqyrtimit të rregullt të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 80 të Ligjit Nr. 03/L040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Shtimes:

K O N F I R M O N

Vendimi Npi-01/46 për caktimin e vendgjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Shtimes, të miratuar me datë 31.10.2024, parashtuar për shqyrtim në MAPL me datën 07.11.2024, pranuar në MBPZHR me datë 13.11.2024, është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë nuk mund të prodhojë efekte juridike.

A r s y e t i m

Vendimi Npi-01/46 për caktimin e vendgjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Shtimes, i miratuar me datë 31.10.2024, nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, parashtuar për shqyrtim në MAPL me datën 07.11.2024, pranuar në MBPZHR me datë 13.11.2024, është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë nuk mund të prodhojë efekte juridike, sepse, duke u bazuar në Legjislacionin në fuqi –

Ligjin Nr. 02/L - 53 për Gjuetinë G.Z. Nr. 8/01 Janar 2007, përcaktohet:

Neni 19, paragrafi 19.2, përcaktohet: “Vendgjuetitë e përbashkëta i Themelon Kuvendi Komunal në territorin e së cilës shtrihet sipërfaqja e tokës në të cilën themelohet vendgjuetia, me propozimin e organit komunal kompetent për punët e bujqësisë, dhe pëlqimin paraprak të ministrisë.

MBPZHR-ja duke u bazuar në legjislacionin në fuqi ka nxjerrë Pëlqim për themelimin e vendgjuetisë të përbashkët me sipërfaqe të përgjithshme 13,430 ha, për Komuna e Shtimes me dt. 20.04.2012, që do të thotë se kjo vendgjueti është themeluar bazuar në pëlqimin e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë sipas Pëlqimit nr. 385/2 të dt. 23.04.2012, në harmoni me dispozitat e legjislacionit për gjuetinë në fuqi.

E Hensler

Me sa duket, Kuvendi Komunal i asaj periudhe nuk ka nxjerrë vendim për themelimin e kësaj vendgjueti, duke mos respektuar dispozitat e nenit 19 paragrafi 19.2 dhe paragrafi 19.4 të ligjit për gjuetinë Nr. 02/L-53, dhe nenit 8 paragrafi (8.1 me të cilin përcaktohet: Vendgjuetitë e përbashkëta i themelon Asambleja Komunale, me propozim të organit për bujqësi të komunës në territorin e së cilës themelohet vendgjuetia me pëlqimin paraprak të ministrisë, paragrafët 8.3 dhe 8.4 të Udhëzimit Administrativ MA – Nr. 10.2007 të datës 14.09.2007.

Vendgjuetia e përbashkët jepet në menaxhim pas marrjes së Pëlqimit nga MBPZHR-ja dhe pas përfundimit të procedurave të prokurimit publik, me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm të kafshëve të egra dhe rregullimit të tyre në aspektin administrativ, duhet të jetë e qëndrueshme e shfrytëzuar sipas tërësisë së ekosistemit, baraspeshës ekologjike, kultivimit, mbrojtjes, dhe shtimit të kafshëve të egra si pasuri natyrore kombëtare me interes të përgjithshëm që gëzon mbrojtje të veçantë në harmoni me nenin 34, paragrafi 34.1 të Ligjit Nr.02/L-53 për Gjuetinë, (GZ. Nr.08, dt.01.01.2007) dhe nenit 3 Udhëzimit Administrativ NR.06/2009, Për dhënie në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta, të datës 31.03.2009.

Drejtori për Ekonomi dhe Financa z. Sabri Çerkini përmes shkresës me nr. 04/117 të dt. 10.5.2021, ka lëshuar në njoftim për dhënie me qira të vendgjuetisë në territorin e komunës Shtime për ndërmarrjen N.Sh. “Shqiponja- Sh” të cilën e ka përfaqësuar Isak Musliu. Kjo do të thotë që kjo vendgjueti është dhënë në menaxhim pa pëlqim të paraprak të ministrisë në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 34. 43.2 të ligjit për gjuetinë Nr. 02/L-53.

Meqenëse kjo vendgjueti ishte e dhëne me qira nga komuna, sipas nenit 44 paragrafi 1 dhe 2 menaxhuesi i vendgjuetisë në këtë rast NSH "Shqiponja Sh", është dashur të dërgojë në ministri numrin e kafshëve të egra në vendgjueti, të cilin ka dështuar ta realizoj, ndërsa në kuadër të dispozitave 42 paragrafi 42 paragrafi 42.1 dhe 42.2 është dashur të nxjerrë planin menaxhues dhjetëvjeçar.

Dispozitat Përfundimtare, Neni 63 paragrafi 63.3 i Ligjit për Gjueti, parasheh që caktimi i vendgjuetive me rëndësi të veçantë dhe të përbashkëta si dhe dhënja e tyre në menaxhim duhet të bëhet në afat prej dy vitesh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nga miratimi i ligjit për gjuetinë. (16.dhjetor 2005).

Meqenëse kemi një situatë të tillë, ku menaxhimi i vendgjuetisë është realizuar në kundërshtim me rregullat e legjislacionit për gjuetinë, po ashtu kemi një ndryshim në sipërfaqe nga 13,430 në 13,450,8 ha (Vendimi 01-060/01-28277/24 të dt. 23.10.2024 me një ndryshim prej 20.8 ha), kemi një ndryshim të gjendjes numerike të kafshëve të egra, si shkak i mos menaxhimit të duhur, propozomë të veprohet në kuadër të dispozitave ligjore të nenit 21 paragrafi 21.4, duke bërë rishikim të kufijve të gjuetisë duke kërkuar për Rithemelim konform gjendjes faktike.

Vendimi Npi-01/46 për caktimin e vendgjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Shtimes, të miratuar me datë 31.10.2024, ka shkelje të shumta ligjore që nga procesi i themelimit, dhënies në menaxhim, të VGJP për përdhën mbi 10 vjeçare, dhe se është në Kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës së Shtimes është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë nuk mund të prodhojë efekte juridike.

Ju faleminderit për vëmendje!



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVES	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E BUJQESISE, PYLLTARISE DHE ZHVILLIMIT RURAL - MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA - MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT	
Adresa / Address: Prishtine / Pristina - Pristina	
Nr. Dokumenti	358/2
Nr. Iq. / Nr. Ser. / No. reg.	1441
Data / Datum / Date	23/04/2012
PRISTINE / PRISTINA / PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development

Zyra e Ministrit-Kancelarija Ministra-Office of the Minister

Date: 20.04.2012

Ref. ZM - 185/12

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mbështetur në Nenet 4, 21 dhe 22 të Ligjit për Administratë Shtetërore të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-189, duke u bazuar në Nenin 8 paragrafi 1.4 të Rregullores Për Fushat e Përgjegjësi Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Nr. 02/2011 të dt. 22.03.2011, Nenit 19 paragrafi 19.2 dhe nenit 34 paragrafi 2 të Ligjit për Gjuetinë Nr. 02/L-53, si dhe në bazë të kërkesës Nr. 358 dt. 15.02.2012 të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa të komunës së Shtimes, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural bien këtë:

Pëlqim

Për dhënie në menaxhim të vend gjuetisë së përbashkët në komunën e Shtimes me sipërfaqe të përgjithshme prej 13.430 ha.

Arsyetimi

Ky Pëlqim arrihet duke gjetur mbështetje në kërkesën e Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa të komunës së Shtimes Nr. 358 dt. 15.02.2012, mbështetur në Ligjin për Gjuetinë dhe në UA. Nr. 06/2009 për Dhënie në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta. Prandaj, me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm të kafshëve të egra dhe rregullimit të tyre në aspektin administrativ, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lëshon pëlqimin për dhënie në menaxhim të vendgjuetisë të theksuara sipas diapozitivi të më sipërm të tij.

Pëlqimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri në MBPZHR
Njoftohen;
Departamenti i Pylltarisë
Agjencia e Pyjeve të Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
K. Komunal Shtime - Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.



Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO




KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Ekonomi dhe Financa
Uprava za Privredu i Finansije/Department of Economy and Finance

Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Data/Datum/Date:	22.12.2012
Nr./Br./No	04/91
Për/Za/To:	Naim Ismajli, kryetar i komunës
Përmes/Preko/Through:	Ejup Ismajli, Përgjegjës i Sektorit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Nga/Od/From:	Sabri Çerkini, Drejtor për Ekonomi dhe Financa
Lënda/Predmet/Subject :	Kërkesë



Bazuar në dispozitat e nenit 19.12 të Ligjit për Gjuetinë nr.03.L-53 dhe Udhëzimit Administrativ nr.10/2007 për kriteret e caktimit të Zonave të Vend Gjuetive, kërkojmë nga Ju që të procedoni me shpalljen e tenderit për Vend Gjuetinë në territorin e komunës së Shtimes me sipërfaqe prej 6377.8ha ose 45.89% nga sipërfaqet e përgjithshme të komunës. Sektori shoqëror disponon me 2926.8ha ose 45.9% ndërsa sektori individual 3451ha ose 54.11%.


Arsyetim

Caktimi i menaxhuesit të Vend Gjuetisë në territorin e komunës së Shtimes do të ketë rëndësi të madhe për mbikqyerjen, ruajtjen e kafshëve të egra nga shkelësit e ligjit të cilët nuk i respektojnë rregullat mbi gjuetinë.

Adresa: Rr. Tiranës, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016 ex 227 mob: 044 287 346 email: sabri.cerkini@gmail.com



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opstine/Mayor's Office

Data/Datum/Date:	04/01/2012
Nr./Br./No	02/01
Për/Za/To:	-----
Përmes/Preko/Through:	-----
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës, Naim Ismajli
Lënda/Predmet/Subject :	Vendim

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Ligjin për gjuetinë, Ligji nr.03/L-53, në mbështetje të Statutit të Komunës së Shtimes, si dhe në bazë të kërkesës së Drejtorisë për Ekonomi e Financa, nr. 04/91, të datës 22.12.2011, Kryetari i Komunës mori këtë:

V E N D I M

- I. Inicohet procedura për shpalljen e tenderit publik për dhënie e zonës së vendgjuetisë në territorin e Komunës së Shtimes.
- II. Shpallja bëhet në bazë të kërkesës së Drejtorisë për Ekonomi e Financa, nr. 04/91, të datës 22.12.2011,
- III. Shpallja duhet të përfshijë periudhën jo më shumë se 10 (dhjetë) vite, si dhe organet kompetente të Komunës së Shtimes duhet të përzgjedhin operatorin më ekonomik në pajtim me procedurat ligjore si dhe ligjin për gjuetinë në Republikën e Kosovës.
- IV. Për ekzekutimin e këtij Vendimi, autorizohet Drejtoria për Ekonomi e Financa, zyra e prokurimit.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Adresa: Rr. Tiranës, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org
<http://kk.rks-gov.net/shtime>



Komuna Shtime

NJOFTIM PËR DHËNIE TË KONTRATËS

<Qira>

Konform Ligjit nr.02/L-53 , Ligji për Gjueti

I AUTORITETI KONTRAKTUES: Komuna Shtime. Drejtoria për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural

II: LËNDA E KONTRATËS: „Qira

II.1.1 Titulli i kontratës : Dhënja me Qira e vedëgjuetisë në territorin e Komunës së Shtimes

III.2 KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “Çmimi më i Lartë ”

IV: DHËNIA E KONTRATËS

IV.4 Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të cilit i është dhënë kontrata: N.Sh. Shqiponja -sh
Shtime

IV.5 Informacione lidhur me vlerën e kontratës

Vlera e përgjithshme përfundimtare e kontratës: Totali i çmimit për vitë 300 €

3. SHIQIMORET

Planifikimi i N.SH. "SHQIPONJA- SH" është që mbrenda territorit të vendëgjahishtë të ngriten 3 shqimore. Qëllimi i këtyre shqimoreve është të ngritet efikasiteti i shiqueshmërisë të asaj pjese të territorit, si dhe bëhet përcjellja e egërsirave të atij tereni përkatës. Do të gjinden pikat më të larta të terrenit në vendëgjahishtë. Dimenzionet dhe lartësia e shqimores do të jetë 3x2m2 x 3 copa. Vlera e njëres shqimore do të jetë rreth 2500x3=7500€.

4. N.SH. "SHQIPONJA – SH"

Ka planifikuar që për kryerjen e punëve më efikase, blerjen e një veture të tipit xhip, për nevojat e saj. Vlera e xhipit sillet rreth 3000€.

5. N.SH."SHQIPONJA – SH" në Shtime planifikon ta rimbushë numrin e Fazanave që është zhdukur në vendëgjahishten e komunës tonë (Shtime).

Investimet në këtë projekt - Fazanat do të jenë rreth 4000€.

6. USHQIMI

N.SH. "SHQIPONJA – SH" planifikon gjatë menaxhimit 10 vjeçarë të investojë në ushqim për egërsirat dhe shpezët:

- | | |
|-----------------|-------------------------------------|
| a) Grunë | 1000kg (vjetor) |
| b) Misër | 1000kg (vjetor) |
| c) Bari i thatë | 1200kg (vjetor) në sezonën dimërore |
| d) Kripë | 500kg (vjetor) |

Vlera totale e ushqimit vjetor është 700x10 vite= 7000€.

N.SH."SHQIPONJA – SH" gjatë menaxhimit 10 vjeçarë do të investon në vlerë totale prej 36100€.

25/01/2012

Shtime

